



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 54-të, të mbajtur më 01.11.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numrin 12-4013/1 datë 15.10.2021, për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor, të dorëzuar nga parashtruesi-----, REFUZOHET

KSHPK konstaton se denoncimi nuk përmban elemente për shkeljeve t; neneve 8-a dhe 8-6 nga Kodi zgjedhorë dhe nenet 33,34 dhe 35 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga ana e një parashtruesi të njohur-----
-----, me datë 13.10.2021, nëpërmjet adresës elektronike në KSHPK është dërguar denoncim me pohime për shkelje të dispozitave ligjore në procesin zgjedhor – Zgjedhjet lokale 2021 dhe është formuar lënda me numër 12 – 4013/1 nga 15.10.2021, Përndryshe në denoncim janë nxjerrë pohime për atë se në fletën për këshilltar të SDSM-së për komunën----- gjendet personi-----i cili emër figuron si këshilltar aktual i komunës-----
----- . Në denoncim pohohet se në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale, anëtarit të këshillit i ndërpritet mandati para skadimit të kohës për të cilën është zgjedhur, nëse pushon së qeni banorë i komunës. Në rastin e denoncuar, nëse është vërtetuar se bëhet fjalë për të njëjtin person, kjo nuk është bërë, kështu që parashtruesi kërkon konfirmim dhe marrjen e hapave të mëtejshme.

Gjatë shqyrtimit të pohimeve, KSHPK konstaton se denoncimi i dorëzuar nuk përmban elemente për shkelje të neneve 8-a dhe 8-6 nga Kodi zgjedhor dhe nenet 33, 34 dhe 35 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, pas së cilës vlerësoi se KSHPK nuk ka kompetencë të vepron sipas pohimeve dhe denoncimi të refuzohet.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi

**KOMISIONI SHTETЁROР
PЁR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorёzuar deri te: Parashtruesi

Punoi: J.C.

Miratoi: K.N, anёtar i KSHPK - sё

